University for Business and Technology in Kosovo
UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations | Student Work

Spring 5-2019

GJUHA E URREJTJES NË PORTALET KOSOVARE

Fortesa Krasniqi
University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd

Part of the Communication Commons

Recommended Citation

Krasniqi, Fortesa, "GJUHA E URREJTJES NË PORTALET KOSOVARE" (2019). *Theses and Dissertations*. 143.
https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/143

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.

Kolegji UBT

Fakulteti për Media dhe Komunikim

GJUHA E URREJTJES NË PORTALET KOSOVARE

Shkalla Bachelor

Fortesa Krasniqi

Maj, 2019

Prishtinë

Kolegji UBT

Fakulteti për Media dhe Komunikim

Punim Diplome

Viti akademik 2013/2014

Fortesa Krasniqi

GJUHA E URREJTJES NË PORTALET KOSOVARE

Mentori: MSc. Musa Sabedini

Maj / 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme

për Shkallën Bachelor.

ABSTRAKT

Duke u nisur nga fakti që sot ndikimi i rrjeteve sociale dhe medieve online është rritur si objekt studimi në këtë punim diplome është marrë gjuha e urrejtjes në disa nga portalet që konsiderohen si më të klikuarat në vend dhe që kanë ndikim në opinionin publik.

Nga ana tjetër edhe gjuha e urrejtjes është një nga format më të shprehura dhe më të diskutuara në komentimet dhe në raportimet e disa lajmeve apo artikujve që publikohen në mediet online dhe që kthehen në temë diskutimi për shumicën e audiencës që i përcjell çdo ditë dhe informohen nga to. Fakti që gjuha e urrejtjes është temë diskutimi dhe vazhdon të mbetet fenomen madje edhe në rritje atëherë edhe është studiuar për këtë punim diplome për një periudhë të caktuar kohore në koordinim edhe me fushat e specializuara ku kemi dalluar më shumë elemente të gjuhës së urrejtjes.

Fjalë kyçe: *Gjuha e urrejtjes, mediet online , raportimi, komentimi.*

MIRËNJOHJE

Do të doja të shpreh mirënjohje për të gjithë ata njerëz të cilët më kanë qëndruar pranë me këshilla dhe sygjerime gjatë këtyre tri viteve të studimeve në kolegjin UBT dhe që me kanë ndihmuar gjithmonë sa herë që kam pasur nevojë.

Ndër tjera dua të falënderoj edhe stafin akademik të këtij kolegji të cilët gjatë këtyre viteve na kanë ndihmuar në përvetësimin e njohurive të reja të cilat kanë qenë dhe mbetën të dobishme edhe në të ardhmen dhe që janë kthyer në ndihmesë edhe për viteve në vijim për karrierën time.

Falënderime dhe mirënjohje të veçanta kam për mentorin tim MSc Musa Sabedini i cili në çdo kohë ka treguar gatishmëri për të më ndihmuar për arritjen e realizimit të këtij punimi të diplomës me sukses.

Gjithashtu një falënderim të veçantë kam për familjen time që me qëndruan gjithmonë pranë.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. **HYRJE……..1**
2. **SHQYRTIMI I LITERATURËS……2**

2.1 Gjuha e urrejtjes si objekt studimi……..….…..2

2.2 Kodi Penal i Kosovës……..…….……9

2.3 Hulumtime dhe analiza nga autorë të huaj dhe shqiptarë…….….…10

3. **DEKLARIMI I PROBLEMIT…….….14**
4. **METODOLOGJIA…….16**
5. **PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE…….17**

5.1 Analizimi i portalit Indeksonline……...17

5.2 Analizimi i portalit Gazeta Express……..24

6. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME…….…31**

REFERENCAT……..32

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Foto nga raportimi i Indeksonline……..17

Figura 2. Foto nga raportimi i Indeksonline……..19

Figura 3. Foto nga raportimi i Indeksonline……..21

Figura 4. Foto nga raportimi i Gazeta Express……..27

Figura 5. Foto nga raportimi i Indeksonline……..28

Figura 6. Foto nga raportimi i Gazeta Express……..29

Figura 7. Foto nga raportimi i Gazeta Express……..30

1 HYRJE

Subjekt kryesor i studimit në këtë punim diplome është gjuha e urrejtjes në raportimet dhe komentimet e portaleve kosovare me më së shumti ndikimin në audience.

Gjatë një periudhë kohore prej 3 muajsh do të analizohen postimet e portaleve më të klikuara dhe do të analizohen sesa kanë në përmbajtjen e tyre gjuhë të urrejtjes dhe sa i përmbushin kriteret kryesore të një shkrim gazetaresk bazuar në rregullat që duhet zbatuar.

Nga 1 nëntori 2017 deri me 31 janar 2018 është periudha e zgjedhur për këtë punim diplome.

Ky punim do të arrijë rezultatet e nevojshme duke përdorur metodën e analizimit dhe të krahasimit. Qëllimi kryesor i këtij punimi është analizimi i portaleve të cekura, dhe sa ka gjuhë të urrejtjes në raportimet dhe komentimet e tyre, si dhe të krahasohen publikimet e këtyre portaleve më tekstet e mirëfillta gazetareske, pra sa këto portale ju përmbahet rregullave kryesore etike të gazetarisë.

Gjuha e urrejtjes është objekt kryesor studimi në këtë punim diplome, dhe si fjalë kyçe do të analizohet dhe interpretohet se çfarë është realisht gjuha e urrejtjes dhe si mund të dallohen elementet e gjuhës së urrejtjes.

Çka është gjuha e urrejtjes a është e pranishme gjuha e urrejtjes në Gazetën Express dhe në portalin IndeksOnline, si është përdorur në raportimet e gazetës, në cilat raste është përdorur më shumë, a ka lajme të cilat janë që nga fillimi deri tek fundi i tekstit gjuhë e urrejtjes, janë disa nga çështjet që do të trajtohen në këtë punim diplome.

Madje ndër tjera do të analizohen edhe komentimet e shumta që shpeshherë dallohen në tekstet gazetare.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Gjuha e urrejtjes si objekt studimi

Gjuha e urrejtjes është një prej çështjeve më të diskutuara në mediat e Kosovës tash e disa vite. Përkufizimi i saj në të shumtën e rasteve ka konotacione të ndryshme, madje shpeshherë është e vështirë për të kuptuar se kur është realisht teksti kryekëput gjuhë e urrejtjes.

Sa herë që dëgjohet termi gjuhë e urrejtjes asociohet me lirinë e shprehjes duke i kthyer të dyja në tema diskutimi, cila po cenon dhe cila po shkel rregullat etike, e cila po kuptohet më shumë dhe cila nuk arrin madje as të ketë kuptim.

Në disa raste madje është e vështirë të përkufizohet se çfarë është realisht gjuha e urrejtjes dhe kur mund të themi se është përdorur gjuha e urrejtjes, ose të paktën kur ka elemente që na çojnë te ky konstatim.

Sipas autorëve Mihaljllova, Baçovska dhe Shekerxhier shenja kryesore për të identifikuar një tekst më gjuhë të urrejtjes janë paragjykimet. “Treguesit, indikatorët që kanë të bëjnë më paragjykimet paraqesin një apo më shumë fakte të cilat tregojnë se gjuha përkatëse mbështetet në paragjykime të atilla të cilat e klasifikojnë në kategorinë e gjuhës se urrejtjes”. (Grup autorësh, 2013:32,33).

Gjuha e urrejtjes është një problem edhe në mediat e Kosovës e sidomos më e shprehur është në portale, shkrime të cilat janë kryekëput gjuhë e urrejtjes.

Sipas Mihaljllova, Bacovskës dhe Shekerxhier indikatorët kryesore për të dalluar një tekst më gjuhë të urrejtjes janë indikatorët e qëllimit, përmbajtjes dhe kontekstit dhe pasojave dhe rezultateve të ndaluara, sipas tyre gjuha e urrejtjes e cenon tregun e ideve dhe ka kapacitet ta dëmtojë strukturën e shoqërisë dhe t`i ndajë komunitetet. (Grup autorësh, 2013:31.32).

Pra për të identifikuar një gjuhë të urrejtjes duhet të kemi parasysh disa elemente kryesore për të përcaktuar sesi është përdorur gjuha e urrejtjes dhe duke marrë parasysh qëllimin se pse është përdorur dhe në çfarë konteksti.

Sipas një hulumtimi të publikuar nga YIHR(nisma e të rinjëve për të drejtat e njeriut) grupet më të targetuara, dhe të sulmuara me gjuhë të urrejtjes janë komuniteti LGBT dhe minoritetet, sipas tyre fjalët më të përdorura nga nëntë portale të analizuara janë “shkije” “magjup” dhe “pedera”.

Në Kosovë ekzistojnë organe të ndryshme që mund të përdoren për të identifikuar dhe dënuar gjuhën e urrejtjes në media. Si organe gjyqësore janë gjykatat, prokuroria dhe policia.

Nga ana tjetër kemi edhe KPM (Komisioni i Pavarur për Media) dhe KMSHK (Këshilli i Mediave të shkruara të Kosovës). (shiko. http://www.kpm-ks.org/?faqe=8HYPERLINK "http://www.kpm-ks.org/?faqe=8&gjuha=1&mod=dokumentet"&HYPERLINK)

Nga ana tjetër YIHR(Nisma e të rinjëve për të drejtat e njeriut) në fund të hulumtimit jep disa rekomandime sesi duhet të mos e përdorim gjuhën e urrejtjes.

Ndër tjerash aty thuhet se mediat online nuk duhet të lejojnë që të ketë komente me gjuhë të urrejtjes, mediat duhet që të kenë kujdes kur publikojnë shkrime për çështje të ndjeshme si komunitetet, mediat nuk duhet që të përmendin përkatësinë fetare pa nevojë dhe me konotacion negativ, mediat duhet të informohen për ligjet kryesore që e dënojnë gjuhën e urrejtjes, duhet që organet kompetente të marrin parasysh rastet dhe të qojnë në zgjidhjen e këtij problemi etj.

Gjuha e urrejtjes është një prej problemeve kryesore që duhet të zgjidhet në mediat tona e sidomos në mediat online-portalet të cilat kanë një liri të tepruar sa i përket raportimit dhe komentimit të çështjeve dhe personave të ndryshëm.

Kodi penal i Kosovës – Dispozitat e posaçme mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të mediave Republika e Kosovës në kodin penal të saj, përkatësisht neni 37 tregon se kryeredaktorët, redaktorët dhe autorët e shkrimeve kanë përgjegjësi penale për çdo rresht të shkruar.

Ky ligj thotë se: *Autori i informacionit është penalisht përgjegjës nëse vepra penale është kryer përmes publikimit të informatës në gazetë ose në lloj tjetër të shtypit periodik radio televizion ose mjete tjera te komunikimit.

Kryeredaktori është përgjegjës atëherë kur autori nuk mund të gjendet apo gjykohet nga gjykata e Kosovës, nëse publikimi është bërë pa dijeninë e autorit, dhe nëse gjatë kohës se publikimit të informatës kanë ekzistuar pengesa faktike dhe juridike për fillimin e procedurës penale.

Pra sipas Kodit Penal të Kosovës secili autor që mund të këtë në tekstin e tij gjuhë të urrejtjes duhet të dënohet me ligj, sepse për secilën shkronjë të shkruar ka përgjegjësi penale.

Nga ana tjetër mediat duhet të monitorohen edhe nga KPM- Komisioni i Pavarur për Media dhe mediat të cilat e shkelin këtë nen dhe mbi të gjitha rregullat kryesore të gazetarisë dhe etikes duhet që të procedohen dhe të marrin përgjegjësi penale.

Por deri tani nuk ka raste që kemi pare të jetë marr ndonjë vendim lidhur me këtë çështje. Madje në disa raste kur dëgjojmë që ka kryekëput gjuhë të urrejtjes, nuk kemi parë ndonjë reagim nga ana e organeve kompetente të cilat duhet të merren direk me këtë çështje.

Por, ndër tjera ka disa nisma që merren me këtë çështje dhe duket që mundohen që të pasqyrojnë një anë tjetër të medaljes.

Nuk ka asnjë sindikatë kryesore që t'i përfaqësojë interesat e gjithëmbarshme të gazetarëve në Kosovë. Në kuadër të RTK-së veprojnë dy sindikata të punonjësve, e që janë Sindikata e punëtorëve të RTK-së dhe Sindikata e Pavarur e RTK-së, ndërsa njëfarë përfaqësimi bëhet edhe përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Megjithëkëtë, nuk ekziston asnjë institucion që do të punonte enkas dhe në mënyrë të organizuar për mbrojtjen e së drejtës në punë të gazetarëve dhe/ose profesionistëve të mediave në Kosovë. Kuadri ligjor në Kosovë garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke vënë themele të forta për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se garantohet edhe zbatimi i ligjeve dhe masave mbrojtëse të veçanta të parapara me këtë kuadër. Sidoqoftë, është shënuar përparim për sa i përket miratimit të legjislacionit. Zhvillim më me rëndësi ka qenë de-penalizimi i shpifjes dhe fyerjes, dhe trajtimi i tij vetëm si çështje civile. Është miratuar Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes15, që rregullon përgjegjësitë civile për shpifje dhe fyerje. Ndryshe nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës,16 që ka paraparë dënim me burg për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes, Kodi i ri Penal i miratuar në vitin 201217 nuk përcaktonte vepra penale të këtilla. Veç kësaj, Kodi i ri i përmbante dy nene kundërthënëse: nenin 37 mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të

mediave (kryeredaktorët, botuesit, shtyp shkronjësit ose prodhuesit) dhe nenin 38 mbi mbrojtjen e burimit të informatës. Pas reagimit të ashpër dhe fushatës pasuese nga mediat, shoqëria civile dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe avokimit të përbashkët nga ana e palëve ndërkombëtare të interesit, dy nenet në fjalë u hoqën krejtësisht18 nga Kodi Penal dhe më 1 gusht 2013 u miratua një Ligj i ri për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë19 . Ligji për qasje në dokumente publike është miratuar në vitin 2010.20

Një studim i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) rreth zbatimit të këtij ligji gjatë gjithë vitit 201221 ka gjetur që të gjitha ministritë kanë caktuar zyrtarë me detyrën për t'i shqyrtuar kërkesat për qasje në dokumente publike.

Krahasuar me vitet e shkuara, është shënuar përparim për sa i përket përgjigjes së institucioneve në kërkesat për qasje në dokumente publike, përkundër ankesave nga mediat dhe shoqëria civile rreth paqartësisë dhe rregullimit të pamjaftueshëm të procedurës vijuese në aktet nënligjore. (https://www.osce.org/sq/kosovo/122391?download=true)

Tema e lirisë së mediave në Kosovë vazhdon të jetë burim i debatit publik. Përkundër gatishmërisë së deklaruar të institucioneve publike për t'u përballur me sfidat në lidhje me lirinë e mediave të identifikuar në këtë raport, demonstruar më së miri nga zelli i miratimit të ligjeve të reja, gazetarët vazhdojnë të jenë të kërcënuar. Derisa grupet e fokusit tregojnë që gazetarët ndjejnë të njëjtën siguri si personat tjerë në profesione tjera, sulmet që lindin si rezultat i kryerjes së profesionit të tyre vazhdojnë të ndodhin.

Megjithatë, përfaqësuesit e sektorit të sundimit të ligjit, si policia dhe prokuroria, theksojnë që ata i ndjekin në mënyrë aktive rastet e dhunës kundër gazetarëve. Megjithatë, të dhënat për vërtetimin e këtyre deklaratave nuk mund të gjenden. Në anën tjetër, korniza ligjore e rregullative relativisht e re tregon që prokurorët e gjyqtarët nuk kanë arritur ende të zhvillojnë kapacitetet dhe t'i kuptojnë plotësisht këto korniza, ashtu që t'i zbatojnë ato plotësisht.

Problemi me aftësinë e gjyqtarëve e prokurorëve për zbatim të ligjeve të mediave është i të njëjtës masë në gjithë spektrin e institucioneve publike, duke marrë parasysh që zbatimi i legjislacionit të ndërlidhur me mediat është i pamjaftueshëm. Sfida më e madhe qëndron tek Ligji për qasje në dokumente publike, ku gazetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile së bashku e theksojnë mungesën e zbatimit të tij.46 Pra, është shumë e qartë që thjesht ekzistenca e ligjit nuk kontribuon në ndonjë përmirësim të vërtetë në praktikë.

Shtetet kanë detyrë pozitive të mundësojnë shfrytëzimin e lirisë së shprehjes dhe jo vetëm të mos ndërhyjnë në rastet kur shfrytëzohet kjo e drejtë. Për detyrimin pozitiv të shtetit, që të mundësojë praktikimin papengesë të lirisë së shprehjes, shpeshherë citohet rasti i Özgür Gündem kundër Turqisë27 ku gjykata kishte konstatuar se shteti nuk e kishte përmbushur detyrimin e vet për krijimin e mundësisë së shfrytëzimit të kësaj lirie. Shtetet kanë detyrime pozitive për ta siguruar lirinë e shprehjes, përkatësisht aplikimin horizontal të nenit 10 në relacion me individët.

Individët duhet ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të komunikimit, ndërsa qasja në informata duhet të jetë e siguruar. Interesi publik duhet të shqyrtohet në kontekst të individit, përkatësisht të ekzistojë balancimi. Gjatë përcaktimit nëse me detyrimin pozitiv të shtetit për të vepruar ekziston në një situatë të caktuar mbahet llogari për balancim korrekt i cili duhet të ekzistojnë midis interesit publik në komunitet dhe interesit të individit. Për shprehjen politike, në kontekst të lirisë së shprehjes, shembull i mirë është aktgjykimi në rastin e Eon-it kundër Francës28.

Ankuesi Erv Eon është shtetas i Francës, i cili në vitin 2008, gjatë kohës së vizitës së Presidentit të Francës, Nikollas Sarkozi në Laval, publikoi pllakat të vogël në të cilin shkruante: “Zhduku, ti i vogli i pagdhendur”. Kjo frazë, praktikisht, ishte fraza e njëjtë të cilën disa muaj më herët e përdori Sarkozi, kur gjatë vizitës së tij në një panair për produkte bujqësore, një bujk kishte refuzuar t’ia shtrinte dorën për tu përshëndetur me të. Më 6 nëntor, të po atij viti, Gjykata e shkallës më të lartë në Laval e shpalli Eon-in fajtor për ofendim të Presidentit të Republikës, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për shtypin, nga 29 korriku të vitit 1881, dhe e kishte dënuar me dënim në para prej 30 euro, i cili më vonë ishte hequr.

Karta e të Drejtave Themelore në Bashkimin Evropian, në nenin 11, i titulluar si “Liria e shprehjes dhe informimit” gjithashtu e thekson lirinë e shprehjes. Neni 11 Karta e të Drejtave Themelore në

Bashkimin Evropian Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin lirinë e pikëpamjeve të tyre dhe lirinë për të marrë dhe dhënë informata dhe ide pa ndërhyrjen e organeve shtetërore dhe pa marrë parasysh kufijtë. Liria dhe pluralizmi i mediave duhet të respektohen. Me rëndësi të veçantë për lirinë e shprehjes, mes tjerash, duhet të theksohet se kjo Kartë ka për qëllim t'u përgjigjet problemeve të cilat burojnë nga zhvillimi aktual dhe ai i ardhshëm i teknologjisë së informacionit. "Ajo i suspendoi dallimet që ishin bërë deri atëherë nga librat evropian dhe ndërkombëtar ndërmjet të drejtave civile dhe politike nga njëra anë, dhe të drejtave ekonomike sociale nga ana tjetër dhe i numëron të gjitha të drejtat e klasifikuara sipas parimeve themelore: dinjiteti, liria, barazia, solidariteti, të drejtat civile dhe drejtësia."37 Institucionet e Bashkimit Evropian kanë obligim ligjor ta respektojnë Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, përfshirë edhe dispozitat e saj për mosdiskriminim.

Kur e aplikojnë të drejtën e BE-së edhe shtetet anëtare të BE-së duhet ta respektojnë Kartën.

"Sa u përket instrumenteve të Këshillit të Evropës, Traktati i Lisbonës në nenin 6 (2) Bashkimi Evropian do të anëtarësohet ndaj instrumentit për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës: Bashkimi anëtarësohet në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Ligji e përcakton se liria e shprehjes është e garantuar dhe se kufizimi eventual ka të bëjë me kushtet strikte konform legjislacionit nacional, si dhe konform marrëveshjeve të vlefshme ndërkombëtare si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kjo dispozitë vetëm e konfirmon rëndësinë e madhe dhe nivelin e mbrojtjes së lirisë së shprehjes meqë edhe pa specifikimin veç e veç të Konventës Evropiane dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut ato paraqesin burime juridike dhe janë pjesë e të drejtës pozitive të vendit. Ligjvënësi ka përcaktuar se ofendimi mund të bëhet me fjalë, gjeste, vizatim, me zë ose në mënyra të tjera por edhe se kategori e mbrojtur, përveç personave fizikë janë edhe personat juridikë, grup personash, si dhe ndonjë person i ndjerë.

Ligji, gjithashtu, përcakton se për ofendimin e bërë përmes mjeteve të informimit publik mund të përgjigjet autori i deklaratës, redaktori ose personi i cili e zëvendëson në mjetin e informimit publik dhe personi juridik. Paditësi, gjatë paraqitjes së padisë, e ka lirinë që të vendos se kundër cilit person nga ky paragraf do ta paraqes padinë për përcaktimin e përgjegjësisë dhe për kompensimin e dëmit i shkaktuar nga ofendimi.

Gazetari, si autor i deklaratës, nuk përgjigjet nëse ajo ka marrë karakter ofendues gjatë përgatitjes, përkatësisht përpilimit të titullit, nëntitullit, fotografive, nxjerrjes së fragmenteve nga teksti integral, prezantimit si titull kryesor ose ndonjë mënyrë tjetër nga ana e redaktorit ose personit i cili e zëvendëson.

Liria e shprehjes, në kontekstin e saj, mundëson shkëmbim idesh dhe pluralizëm që të realizohet pasuria e mendimit dhe përmes komunikimit të realizohet demokracia dhe diskursi politik. Prandaj edhe kufizimet e saj duhet të kalojnë përmes një filtri të rreptë me qëllim që e njëjta të mos rrezikohet apo abuzohet. Gjatë shqyrtimit të rasteve të kufizimit të lirisë së shprehjes mund të identifikohen raste kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime. Ky mekanizëm mundëson që të mos abuzohet liria e shprehjes dhe të mos orientohet drejt të kundërtës së plotë të kësaj lirie, siç është gjuha e urrejtjes e cila është abuzimi më serioz i mundësisë së shprehjes.

Gjuha e urrejtjes hap probleme të pakëndshme dhe komplekse për shoqëritë bashkëkohore, të cilat i janë përkushtuar respektit dhe kultivimit të pluralizmit kulturor dhe tolerancës. Rregullimi i çështjes së gjuhës së urrejtjes, në masë të madhe, është një fenomen i Luftës së Dytë Botërore. Të nxitur nga lidhjet evidente ndërmjet propagandës raciste dhe Holokaustit, më shumë marrëveshje ndërkombëtare, por edhe vende të veçanta, e apostrofuan gjuhën e urrejtjes si të papranueshme dhe në kundërshtim me të drejtat e mbrojtura me kushtetutë.

2.2 - KODI PENAL I KOSOVËS

Kodi penal i Kosovës – Dispozitat e posaçme mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të mediave

Republika e Kosovës në kodin penal të saj, përkatësisht neni 37 tregon se kryeredaktorët, redaktorët dhe autorët e shkrimeve kanë përgjegjësi penale për çdo rresht të shkruar. Ky ligj thotë se:

*Autori i informacionit është penalisht përgjegjës nëse vepra penale është kryer përmes publikimit të informatës në gazetë ose në lloj tjetër të shtypit periodik radio televizion ose mjete tjera te komunikimit.

*Kryeredaktori është përgjegjës atëherë kur autori nuk mund të gjendet apo gjykohet nga gjykata e Kosovës, nëse publikimi është bërë pa dijeninë e autorit, dhe nëse gjatë kohës se publikimit të informatës kanë ekzistuar pengesa faktike dhe juridike për fillimin e procedurës penale.

Pra sipas Kodit Penal të Kosovës secili autor që mund të këtë në tekstin e tij gjuhë të urrejtjes duhet të dënohet më ligj, sepse për secilën shkronjë të shkruar ka përgjegjësi penale.

Nga ana tjetër mediat duhet të monitorohen edhe nga KPM- Komisioni i Pavarur për Media dhe mediat të cilat e shkelin këtë nen dhe mbi të gjitha rregullat kryesore të gazetarisë dhe etikes duhet që të procedohen dhe të marrin përgjegjësi penale.

Kuptohet se jo çdo gjë që ofrojnë mediat është gazetari thotë Stephan Russ-Mohl dhe natyrisht se as ky tekst nuk është tekst gazetar.(Russ Mohl, 2010:14).

Shpeshherë kur ngre supozime koha mund ta provojë se ki të drejtë, pikërisht kjo i bën ato të rrezikshme. Si reporter duhet të përcjellësh vetëm atë që di jo atë që mendon që di" thotë David Randall.(Randall, 2003:51)

“Në gazetarinë online jepet mundësia që të lidhësh sipas dëshirës tekstet dhe format e paraqitjes audio-vizive e t`i rilidhësh ato sërish me njëra tjetrën, specialistët flasin për konvergjencë, për prirjen që kanë mediat e tanishme për tu shkrirë me njëra tjetrën në një medium të vetëm universal”.

Në fakt edhe në mediet online në Shqipëri raportohet për gjuhë të urrejtjes, madje janë të evidentuara edhe me hulumtime të bëra nga disa hulumtues të cilët madje edhe kanë ardhur me disa konkludime se ka gjuhë të urrejtjes, por jo me përqindje të madhe.

Rreth 21 për qind e lajmeve, opinioneve dhe analizave të publikuara në median online gjatë muajve nëntor-dhjetor 2016 përmbanin gjuhë diskriminuese dhe urrejtjeje, zbuloi një projekt pilot i monitorimit të raportimit nga mediat online në Shqipëri.

Monitorimi i përqendruar te grupet e margjinalizuara dhe respektimi i të drejtave të njeriut u krye nga redaksia “Historia Ime” dhe organizata Pro LGBT me mbështetjen e Civil Rights Defenders.

2.3 Hulumtime dhe analiza nga autorë shqiptarë dhe të huaj

Mbi 200 artikuj janë monitoruar në katër media online Gazeta Tema, Balkanweb, Panorama dhe Syri.net të përzgjedhura bazuar te klikimet, linja editoriale dhe ndikimi në opinionin publik.

Në analizë janë marrë përmbajtja e artikujve, por edhe elementë të multimedias, si video dhe foto.

Sipas raportit në 57% të rasteve, shënjestër e artikujve me një përmbajtje denigruese ishin individët, ndërsa në 43% të rasteve gjuha e urrejtjes/diskriminuese iu drejtua grupeve shoqërore (LGBT, komunitetit rom, grave, grupeve etnike apo atyre me bindjeve politike të caktuara).

Monitoruesit megjithatë vërejtën se në shumë raste individët janë bërë objekt i këtyre artikujve për shkak të grupeve shoqërore që përfaqësojnë. Në 73% të rasteve viktima të diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes ishin gratë.

Krahasuar me monitorimin e vitit 2015, kjo përbën një rritje nga raporti 59% gra dhe 41% burra.

Përkatësia gjinore ishte shkaku kryesor i diskriminimit/gjuhës së urrejtjes në 41% të rasteve; pasuar nga etnia/raca 22%, bindjet politike në 17% dhe orientimi seksual apo identiteti gjinor në 11% të artikujve të monitoruar.

Të dhënat e monitorimit tregojnë se forma më e përhapur e shprehjes së gjuhës së urrejtjes/ diskriminuese është përmes shtrembërimit të fakteve, apelit të rremë ndaj personave, fajësimeve dhe aludimeve. Pjesa më e madhe e viktimave të kësaj forme diskriminimi kanë qenë persona të përfshirë në krime të dhunshme apo viktima të dhunës në familje.

"Ne besojmë se media nuk mund të jetë thjesht zëdhënëse e homofobisë, diskriminimit racor apo atij me bazë gjinore duke u bërë legjitimuese e tyre, por ka përgjegjësinë t'i luftojë ato duke vënë etikën përpara nevojës për klikime", tha për BIRN Kristi Pinderi drejtor i Pro LGBT.

Pinderi beson se monitorimi i medias është i nevojshëm për të tërhequr vëmendjen ndaj lidhjes së gjuhës së urrejtjes dhe dhunës që përjetojnë grupet e margjinalizuara në jetën e përditshme.

"Në punën tonë me LGBTI e kemi konfirmuar se sa herë ka shtim të dukshmërisë së çështjeve LGBTI, po aq herë ka shtim të gjuhës së urrejtjes në media. E për pasojë kjo ndikon direkt në dhunën verbale, psikologjike e fizike ndaj LGBTI," shtoi ai, duke vërejtur se i njëjti mekanizëm zinxhir ndodh edhe me grupet e tjera, sidomos me gratë dhe komunitetin rom.

Sipas monitoruesve, shumica e artikujve që përmbajnë gjuhë urrejtjeje apo diskriminuese nuk publikohen me emrin e plotë apo inicialet e autorit.
(khr.https://www.reporter.al/gjuha-e-urrejtjes-ne-median-online-mbetet-shqetesuese-thote-monitorimi/)

Gjuha e urrejtjes dhe keqinformimi janë çështjet më problematike me të cilat po ballafaqohen Mediet Online në Kosovë.

Kjo si pasojë që çdo individ ka mundësinë të plasojë lajme edhe pse nuk është profesionist në media.

Kështu u tha në konferencën me temë "Gjendja e Medieve Online në Kosovë", e organizuar nga misioni i OSBE-së, raporton Ekonomia Online.

Dane Koruga përfaqësues i misionit të OSBE-së në Kosovë, ka thënë se sfidat e para që i sheh në Mediet Online në Kosovë janë gjuha e urrejtjes dhe keqinformimi e që po bëhet edhe prej njerëzve jo profesionistë.
(khr.http://zeri.info/aktuale/145556/gjuha-e-urrejtjes-dhe-keqinformimi-po-sfidojne-mediet-online/)

"Sfidat e para që i shoh në Media Online janë gjuha e urrejtjes, keqinformimi dhe kjo po jep mundësi edhe përmbajtjes së gjeneruar nga lexuesi dhe këtu po flasim për njerëz që nuk janë profesionist. Shpresoj që do të mund t'i trajtojmë këto sfida dhe të paktën Mediet Online t'i sjellim në binarë", ka thënë ai.

Imer Mushkolaj, kryesues i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës, ka thënë se duhet punë dhe angazhim i gjithëmbarshëm që mediet në përgjithësi të rregullohen dhe të respektojnë kodin.

Ai ka thënë se problem tek Mediet Online mbetet edhe pronësia.

"Mediet e caktuara nuk duan ta respektojnë kodin respektivisht nuk duan të respektojnë në raste të caktuara pjesë të këtij kodi. Kur themi gjendja e medieve Online në Kosovë na bjen në mendje menjëherë mënyra se si ato funksionojnë në aspektin e qëndrueshmërisë financiare që është një ndër problemet, na bjen më mendje mënyra se si ato funksionojnë respektivisht se çfarë etniteti janë në kuptimin e bizneseve ose si medie që raportojnë e që ne në fakt i shfrytëzojmë shërbimet kushtimisht të tyre dhe po ashtu na bien në mendje pronësia e këtyre medieve", ka thënë ai.
(khr.http://zeri.info/aktuale/145556/gjuha-e-urrejtjes-dhe-keqinformimi-po-sfidojne-mediet-online/)

Kurse Agron Bajrami kryeredaktor në gazetën "Koha Ditore", ka thënë se shqetësues mbetet edhe fakti i përpjekjes për të lansuar informata të rrejshme me synim të përfitimit politik apo ekonomik.

Ai ka thënë se sfidë për portalet mbetet edhe joprofesionalizmi.

“Problemi është se tash për shkak se kemi një situatë ku secili individ potencialisht sepse ka mundësi përmes rrjeteve sociale me ndiku në masë shumë të madhe te audienca dhe prandaj atë me shndërrua në një fake medium dhe kjo është ajo që ndodhë. (khr.http://zeri.info/aktuale/145556/gjuha-e-urrejtjes-dhe-keqinformimi-po-sfidojne-mediet-online/)

Ne e kemi një situatë në Kosovë ku shumë prej tyre që po i quajmë portale nuk janë mediume sepse nuk kanë të punësuar njerëz si gazetarë, as redaktorë, as lektorë as fotografë por janë një njëri që e kryen të gjithë punën”, ka thënë ai.

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Pse kjo temë?

Tema “Gjuha e urrejtjes në portalet kosovare” ka për qëllim që të nxjerr në pah elementet kryesore të raportimit të gazetareve të fushave të ndryshme.

Duke u nisur nga fakti që mediet online janë kthyer në burim informacioni për shumicën e njerëzve sigurisht që edhe ndikimi i tyre është tejet i madh.

Për këtë temë është hulumtuar për një periudhë kohore 3 mujore duke parë se si mediet e përzgjedhura i kanë trajtuar në mënyra të ndryshme individë të caktuar të shoqërisë.Portalet janë trend botëror dhe natyrisht që edhe në vendin tonë përcillet kjo tendencë andaj edhe vëmendja tek këto shkrime online është maksimale. Gjuha e urrejtjes është një temë e cila duhet trajtuar me shumë kujdes sepse mund të prekë pjesëtarë të ndryshëm të shoqërisë.

Një nga arsyet kryesore përse është zgjedhur kjo temë është sepse ndikimi që ka arritur të ketë medie online e ka kthyer edhe në një problem raportimin për shumicën e gazetarëve dhe për shumicën e audiencës të cilët informohen zakonisht nga këto mediume.

Duke u nisur edhe nga fakti që trajtohen shpeshherë edhe tema delikate të shoqërisë vëmendja më e madhe bie tek ato shkrime të cilat me ose padashje kthehen në gjuhë të urrejtjes.

Në portalet kosovare shpeshherë nuk ka rëndësi se për çfarë fushe shkruhet qofshin ato tema politike apo edhe të rubrikave tjera, me rëndësi janë bërë marrja e klikimeve të shumta brenda një lajmi që në shumicën e rasteve as lajm nuk mund të quhet.

Marr shkas edhe nga këto tendenca dhe duke e ditur faktin se është e vështirë të dallohet gjuha e urrejtjes sepse ka raste kur janë të qëllimshme e kjo zakonisht ndodh tek lajmet politike për përkrahur një subjekt të caktuar politik.

Prandaj është zgjedhur kjo temë e cila mund të trajtohet në vazhdimësi sepse dita ditës rritet edhe ndikimi i portaleve në audiencë.

4 METODOLOGJIA

Në këtë punim diplome synohet që të arrihen përgjigje për pasqyrimin e lajmeve në portalet kosovare dhe sa ato arrijnë të raportojnë pa pasur gjuhë të urrejtjes.

Ndër tjera në këtë punim diplome analizohen edhe përdorimi i figurave në tituj dhe në artikujt në portalet të cilat janë me më së shumti ndikim në Kosovë.

Për të shtjelluar temën e punimit dhe për të dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara, punimi përmban edhe aspektin teorik i bazuar në literature përkatëse.

Autorët shqiptarë por edhe të huaj të cilët kanë trajtuar në libra dhe hulumtime aspektin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Gjatë kërkimit në portalet të cilat janë përzgjedhur për hulumtim, janë gjetur edhe artikuj që janë shembuj tipik të gjuhës së urrejtjes.

Për këtë punim diplome është përdorur analiza krahasuese dhe e diskursit, metoda këto që janë tipike për një punim diplome me një temë të tillë.

5 PREZANTIMI DHE ANALIZIMI I REZULTATEVE

5.1 Analizimi i portalit IndeksOnline

Portali IndeksOnline është një nga portalet më të klikuara në vend duke u nisur edhe nga listimi që i bëhet në Alexa.com.

Në kapitujt e mësipërm kemi treguar definicionin e saktë të gjuhës së urrejtjes çka është edhe objekt studimi në këtë temë diplome.

Në fakt, duke u nisur edhe nga përzgjedhja e mostrës së qëllimshme, janë marrë për studim disa artikujt të cilët janë krye këput gjuhë e urrejtjes, madje në disa raste mund të themi që ka ndonjë përjashtim.

Por këto përjashtime nuk dallohen shumë për shkak se tekstet kanë gjuhë të urrejtjes direkt për individin e përfshirë në artikull.

Gjatë analizimit kemi dalluar se në këtë portal titujt mund të jenë me gjuhë të urrejtjes, por jo edhe brendësia e artikullit, sepse titujt janë më shumë kontradiktor me tekstin që ka në përmbajtje. Por kjo kuptohet duke u nisur nga fakti që gjithmonë tendenca kryesore sot e medieve online është arritja e klikimeve ani pse jo me ndonjë lajm të vërtet.

Prandaj ju jepim rëndësi të veçantë titujt, për të bërë audiencën për të klikuar direkt në lajmin që në brendësi ka krejtësisht tjetër përmbajtje.

Ndryshe, janë analizuar disa kategori që janë më të klikuara në portalin e përzgjedhur. Shembull tipik për të demonstruar është artikulli “Enca je ka e tepron, me këto provokime na ke ‘lodhë’ (Foto)”.



SHPËRNDAJE

0

0

PËLQEJE

8 Like

Tweet

20:57 / E Mërkurë, 10 Janar 2018

Enca je ka e tepron, me këto provokime na ke 'lodhë' (Foto)

Enca Haxhia në të shumtën e rasteve shfaqet provokative.

Këngëtarja e njohur nga Shqipëria, edhe kësaj radhe ka nxjerrë në plan të parë gjoksin – shkruan Indeksonline.

Kujtojmë se Enca sot gjatë ditë ka lajmëruar se është gati për këngën e re te cilen do ta publikojë së shpejti./Indeksonline/

Figura1. Foto nga raportimi i IndeksOnline

Madje në këtë artikull gazetari e ka nisur me folje ofenduese ndaj personazhit në fjalë. Por më shumë bie në sy fakti që gazetari është munduar edhe t'i dërgojë një mesazh personazhit.

Gjë që nuk i takon fare gazetarit në këtë rast. Madje duke u nisur edhe fakti që artikulli duke u nisur që edhe nga titulli nuk është fare informues por komentues, thënë më mire gazetari mundohet që t'i dërgojë një mesazh këngëtares së njohur Enca.

Madje titujt për Encën në të shumtën e rasteve kanë këtë konotacion në raportimet dhe lajmet e këtij portali. Madje ajo që kemi dalluar në këtë periudhe analizimi, fakti që ka gjithmonë një lajm për të, por gjithmonë me konotacione të tilla.

Por gazetari/gazetarja gjithmonë duhet të ketë akoma më shumë kujdes në këtë lloj raportimi, sepse edhe padashje mund të ndodh që teksti të përfundojë me konotacion negative apo me elemente të gjuhës së urrejtjes.

Por duke u nisur nga rregullat gazetare nuk lejohet që as në tituj e as në brendësi të artikullit të përdoren folje dhe mbiemra të tillë. Po të përdoreshin mbiemrat marrëdhenior do të ishte e pranueshme, por në këtë rast kemi mbiemra cilësor që kategorikisht nuk lejohen brenda një teksti gazetar, sepse në këtë formë mund të kategorizohet si gjuhë e urrejtjes, ani pse ka raste kur mund të përdoren këta lloje të mbiemrave edhe për lëvdata, por jo në tekstin e mësipërm.

Madje në secilin paragraf të shkruar për këngëtaren Enca shohim përdorim të mbiemrave cilësor dhe asnjëherë marrëdhenior, duke na çuar kështu në konkludimin që teksti nuk do duhej të kategorizojë në lajme por në komente të gazetarit/gazetares që ka shkruar këtë artikull me gjuhë të urrejtjes dhe aspak informues.

Por çka është realisht gjuha e urrejtjes?

Në fakt në këtë portal gjatë periudhës së analizimit janë gjetur edhe disa artikujt në kategori tjera.

Një rast tipik është tek ballina e këtij portali, madje në rubrikën e lajmeve kryesore nga vendi.

“Veturat e ‘gjumit’ në Prishtinë [Foto]” është titulli i një nga artikujt e postuar në këtë portal duke përdorur edhe metaforë brenda një titulli, kjo lejohet edhe në disa lloje të teksteve gazetare, por në këtë rast nuk lidhet me artikullin brenda që është i shkruari nga gazetari. (khr.http://indeksonline.net/veturat-e-gjumit-ne-prishtine-foto/)

15:18 / E Diele, 07 Janar 2018

Veturat e ‘gjumit’ në Prishtinë [Foto]

Derisa qytetarët në Prishtinë kanë probleme të mëdha me parkingun e veturave, disa nga to ka vite që qëndrojnë të pa lëvizura në parkingje.

Drejtuesit e Komunës së Prishtinës, patën thënë se janë mbi 1.500 vetura që nuk përdorën dhe me vite nuk kanë lëvizur nga parkingjet e ndërtesave, të cilat përveç që bllokojnë hapësirat publike, prishin edhe pamjen e qytetit.

Një e veturë është edhe afër EULEX-it, ku banorët kanë thënë se ka bllokuar parkingun dhe nuk ka lëvizur qe dy vite. Ne po ua sjellim edhe disa nga këto vetura.

Figura 2. Foto nga raportimi i Indeksonline

“Bleona s’ka fije turpi, përsëri shfaqet pa të brendshme (Foto)” (khr. http://indeksonline.net/bleona-ska-fije-turpi-perseri-shfaqet-pa-te-brendshme-foto/)

Gjuhë të urrejtjes kemi hasur edhe tek një artikull tjetër në këtë portal, ky në këtë rast gazetari/gazetarja ka zgjedhur që përmes titullit të shpreh mendimet personale gjë e cila nuk është se shkruhet në ndonjë rregullore gazetareske.

Në këtë rast gazetari ofendon personazhin në fjalë por brenda artikullit nuk gjejmë ndonjë indikacion të gjuhës së urrejtjes.

Madje ajo që dallohet në portalet kosovare është fakti që gjuhën e urrejtjes e përdorin në të shumtën e rasteve me të njëjtët personazhe, duke na krijuar kështu mendimin që ka një luftë personale mes mediumit apo gazetarit karshi personazhit që përmendet në artikull.

Por duket që kjo nuk ju bën shumë përshtypje portaleve që vazhdojnë e shkruajnë të tilla gjëra.

Një element që e kemi dalluar tek ky portal është fakti që gjithmonë lajmet për Bleonën, kuptohet në periudhën kohore të cekur për këtë punim diplome, gjithmonë kanë tendencë për të pasur gjuhë të urrejtjes, nëse jo në krejt artikullin, të paktën në titullin që shkruhet për të.

Kjo del edhe tek një element tjetër që pasqyrohet në këtë punim. Fakti që jo gjithmonë kanë guxim për të përdorur gjuhë të urrejtjes tek secili lajm por tek të disa kategori, pa marrë parasysh se cilat mund të jenë ato.

Njëlloj mund të ceket tek artikujt që shkruhen për këngëtaren Bleona Qereti tek ky portal. Madje edhe foljet që përdoren janë të tipit paragjykues karshi këngëtares së njohur.

17:19 / E Martë, 26 Dhjetorë 2017

Bleona s'ka fije turpi, përsëri shfaqet pa të brendshme (Foto)

Bleona Qereti doemos po kërkon të ketë vëmendjen e të tjerve.

Këngëtarja e njohur në fotosesionin për festat e fundvitit është munduar të joshë si gjithmonë, shkruan Indeksonline.

bleona

Figura 3. Foto nga raportimi i IndeksOnline

Edhe në një artikull tjetër të cilin e kemi gjetur në portalin IndeksOnline dallojmë gjuhë të urrejtjes të përdorur nga gazetari. Në fakt ai ka zgjedhur sërish të ofendojë personazhin e cekur në artikull, madje në këtë rast edhe brenda artikullit gjejmë fjali të përdorura të gjuhës së urrejtjes.

Një fjalë tjetër e përdorur brenda këtij artikulli është “shfrenuar” duke e quajtur edhe me emra tjerë personazhin e cekur në artikull.

Por gazetari/gazetarja gjithmonë duhet të ketë akoma më shumë kujdes në këtë lloj raportimi, sepse edhe padashje mund të ndodh që teksti të përfundojë me konotacion negative apo me elemente të gjuhës së urrejtjes.

“Motra e këngëtares së njohur ekspozon pa fije ‘turpi’ gjoksin bombastik (Foto)”

Siç e kemi cekur edhe më lart gjatë analizimit në këtë portal kemi dalluar gjuhë të urrejtjes edhe në rubrikat e tjera, por çfarë bie më shumë në sy është fakti që në këtë portal gjejmë më shumë gjuhë të urrejtjes në titujt e jo në artikujt.

Gjuhë të urrejtjes në këtë portal hasim edhe në rubrikat ku qytetarët informohen për ngjarjet aktuale në vend, rajon dhe botë.

Një shembull tjetër është : “Pa fije turpi e rrah nënën dhe babain, e arreston Policia e Kosovës”.

Si duket portali IndeksOnline në të shumtën e rasteve për të përmendur përdorimin e gjuhës së urrejtjes e kanë përdorur në versionin e njëjtë.

Duket që portali i lartcekur e ka dalluar se çfarë realisht mund të klikohet nga audienca e tyre që kanë në rrjete sociale. Madje shohim që shumica e titujve shkruhen në zhargon dhe kjo bën që ndonjëherë edhe të keqkuptohet pjesa e gjuhës së urrejtjes. Shprehje të shumta të cilat i dëgjojmë në përditshmëri i shohim në titujt e portalit të cekur dhe të analizuar në këtë punim diplome.

Të tipit “Pa fije turpi” që e kemi hasur në një numër të madh të artikujve gjatë periudhës së analizimit që ka qenë tremujor. (shiko. http://indeksonline.net/pa-fije-turpi-e-rrah-nenen-dhe-babain-e-arreston-policia-e-kosoves)

Por gazetari/gazetarja gjithmonë duhet të ketë akoma më shumë kujdes në këtë lloj raportimi, sepse edhe padashje mund të ndodh që teksti të përfundojë me konotacion negative apo me elemente të gjuhës së urrejtjes.

Edhe në artikullin e lartpërmendur e kemi gjetur po të njëjtën fjali.

Njëlloj edhe këtu e kemi të përdorur vetëm në titull e jo në brendësi të tekstit. Dhe kështu shihet një lloj raportimi që niset për klikime e dikur kujtohen për informimin e publikut, çka realisht duhet të jetë në këtë secilin lajm që publikohet. Por duket që më e rëndësishme është arritja e klikimeve të shumta për secilën lajm të publikuar pa ju interesuar nëse ka apo jo gjuhë të urrejtes.

Si duket portal IndeksOnline ka edhe artikujt të cilët japin mbiemra të shumtë apo thënë më mirë epitete ndaj personazheve për të cilët shkruajnë.

Në artikullin e analizuar me titull "Kjo bukuroshe nga sot është këshilltare e një ministri (Foto)" shohim më shumë lajm të konteksti që e përmendura ka siguruar punën vetëm për shkak të bukurisë duke ulur poshtë vlerat e saj tjera.Madje artikulli është që nga fillimi deri në fund vetëm se si këshilltarja është vetëm e bukur duke mos treguar asgjë më shumë për të. (khr. http://indeksonline.net/kjo-bukuroshe-nga-sot-eshte-keshilltare-e-nje-ministri-foto/)

Ajo që vlen të ceket në këtë hulumtim është fakti që në të gjitha raportimet e bëra nga IndeksOnline del që ata kanë një tendencë që vetëm tek disa individë të caktuar të kenë tekste me gjuhë të urrejtjes ose me elemente të gjuhës së urrejtjes.

Ajo që ceket dhe dallohet më shumë në këtë mes është fakti që gjithmonë kanë një tendencë që më shumë të kenë këso tekste tek lajmet për showbiz.

5.2 Analizimi i portalit GazetaExpress

Për të analizuar lidhur me këtë hulumtim kemi zgjedhur edhe portalin GazetaExpress, e cila konsiderohet si portali më i klikuar në trojet shqipfolëse. Duke u nisur edhe nga fakti se është shumë i lexuar ka edhe më shumë përgjegjësi për të raportuar korrekt dhe saktë.

Si edhe tek portali IndeksOnline edhe tek GazetaExpress janë zgjedhur disa artikuj tek të cilët kemi evidentuar raste kur ka gjuhë të urrejtjes, dhe numri më i madh është tek ata artikujt ku ka tituj më goditës, që në fakt janë më shumë ofendues.

Po e nisim me një artikull të cilin e kemi gjetur në rubrikën rozë të këtij portali.

Gjatë këtij artikulli kemi parë se gazetari ka përdorur një titull i cili më shumë shpreh bindjet e tij/saj rreth veshjes së këngëtares.

E sipas shumë rregullave gazetareske kjo gjë nuk duhet lejuar ani se ky artikull i përket një fushe jo shumë serioze, por duhet pasur kujdes sepse këtë artikull ka mundësi ta lexoj edhe ndonjë i mitur.

Nëse më parë kemi rastisur artikuj tek të cilët kemi hasur thjesht mendim apo interpretim të gazetarit, artikulli i mëposhtëm është më shumë ofendim sesa një raportim i gazetarit lidhur me lajmin për personazhin në fjalë.

Një titull si ky i listuar më poshtë përveç që nuk përben lajm, pra fillimisht shkel rregullin kryesor të raportimit, përveç kësaj edhe ofendon këngëtaren duke thënë se nuk di të bëj asgjë, duke i ulur vlerat si një këngëtare.

Në fakt në rastet të cilat janë evidentuar shenja të gjuhës së urrejtjes më shumë kanë qenë në artikujt të rubrikave rozë, dhe pikërisht edhe artikulli i radhës tregon një shembull tipik të gjuhës së urrejtjes. Madje ata kanë vendosur që edhe të ofendojnë këngëtaren përmes titullit të listuar më poshtë.

Por më e çuditshmja qëndron tek fakti se janë vetëm titujt të cilët kanë gjuhë të urrejtjes por jo edhe artikulli në brendësi, dhe kjo për shkak të tërheqjes së audiencës për ta klikuar lajmin, ani pse brendësia me titullin nuk kanë fare lidhje logjike, duke e keqkuptuar edhe audience e cila e lexon.

Edhe në artikullin e mësipërm kemi një përjashtim. Nëse në rastet e tjera kemi parë që nuk ka lidhje logjike mes artikullit në brendësi dhe titullit, ky artikull ka gjuhë të urrejtjes edhe brenda tekstit.

Titulli niset "me mbulon celuliti" duke e ofenduar në këtë formë personazhin për të cilin flitet, edhe brenda tekstin vazhdon i njëjti avaz.

Po i njëjti avaz vazhdon edhe në këtë artikull. Rubrika rozë e portalit Gazeta Express duket se ka një hatërmbetje me personazhin e cituar më lart, sepse ka një sëri shkrimesh ku flitet për trupin e moderatores shqiptare duke hedhur poshtë vlerat e saj si prezantuese.

Në këtë artikull komentohet gjoksi i prezantueses, ndërsa ka pasur raste kur edhe shikojmë ofendime për moderatoren. Madje në shumicën e shkrimeve për moderatoret shqiptare ka tendenca që të ofendohen për shkak të paraqitjes së tyre fizike. Duke u munduar që përmes tekstit të ngjallin kërshëri tek audienca kalojnë në ofendime dhe në kryekëput gjuhë të urrejtjes.

Madje është një nga shembujt më të shpeshtë të gjuhës së urrejtjes së këtij portalit ndaj moderatores në fjalë.

Dhe vjen të konkludime që lufta virtuale vazhdon mes portalit/gazetarit/gazetares dhe moderatores shqiptare, që pavarësisht rrethanave nuk është etike një raportim i tillë karshi saj.

Njëlloj si edhe në portalin IndeksOnline edhe tek GazetaExpress ka raste kur gjejmë shembuj edhe në ballinë të portalit, madje thënë më mirë në rubrikën e lajmeve aty ku informohen ndjekësit e këtij medium.

Ajo çfarë kemi dalluar më shumë tek ky portal, saktësisht tek rubrika e lajmeve është një sagë e sulmeve ndaj Vetëvendosjes, e njëlloj kanë vepruar edhe në artikullin e cekur me lart.

Titulli i këtij artikulli përmban fjalën "shthurje" që i referohet Vetëvendosjes, pra duke e përgjithësuar të gjithë partinë, ndërsa brenda artikullit ka të cekur vetëm disa personazhe.

Titujt të tillë referuar Vetëvendosjes gjejmë shumë shpesh në ballinën e GazetësExpress.

Edhe në artikullin e cekur më lart kemi rast tipik të gjuhës së urrejtjes, madje duket se edhe kanë vendosur që të ofendojnë personazhet e cekura në artikullin më lart, madje duket se kanë vendosur edhe që të ju japim epitete të ndryshme.

Edhe në këtë artikull Gazeta Express ka përdorur terme që nuk janë adekuate për artikullin dhe temën e trajtuar në këtë artikull. Madje përdoret termi "Linçim" drejtuar Shpend Ahmetit.

Natyrisht që portalet kosovare raportojnë edhe për pjesëtarë të shoqërisë të cilët konsiderohen si më të ndjeshëm ndaj çështjeve të caktuar.

Portalet e përzgjedhura për këtë punim ka pasur raste gjatë periudhës që është analizuar të raportojnë edhe për prostitucion dhe fëmijë, dy tema shumë të ndjeshme për të raportuar, Akoma më shumë kur janë dy elemente shumë të ndjeshme.

Madje raportimet e bëra për kategori të shumta të cilat mund të jenë shumë të ndjeshme dhe raportimet duhet të bëhen me shumë kujdes.

Madje gjithmonë duhet që gazetari të ketë kujdes kur raporton për disa kategori të ndjeshme, rast tipik janë lajmet ku janë të përfshirë fëmijët.

Madje në portalet e zgjedhura për këtë temë diplome është raportuar edhe për fëmijë, madje për çerdhe dhe është raportuar me elemente të gjuhës së urrejtjes.

Ka raste që raportohet edhe për prostitucion dhe gjithmonë është tendenca që të përdoren shprehje jo adekuate, madje ka raste që raportimi mund të ketë konotacion me gjuhë të urrejtjes për shkak të temës delikate dhe rasteve të tilla të raportuara.

Por gazetari/gazetarja gjithmonë duhet të ketë akoma më shumë kujdes në këtë lloj raportimi, sepse edhe padashje mund të ndodh që teksti të përfundojë me konotacion negative apo me elemente të gjuhës së urrejtjes.

Figura 4. Foto nga raportimi i GazetaExpress

Ka raste që është raportuar për arrestime të individëve të caktuar për prostitucion mirëpo në shkrimet e përmendura nuk ka gjuhë të urrejtjes.

Një nga elementet kryesore të cilat duhet ruajtur gjatë këtyre raportimeve është identiteti i të akuzuarit, gjë e cila është bërë si nga GazetaExpress, njësoj edhe nga IndeksOnline.

Figura 5. Foto nga raportimi i IndeksOnline

Një element tjetër të cilin e kemi dalluar gjatë analizimit të këtyre portaleve është rastet kur është dashur që të raportohet për fëmijët që janë pjesëtarët më të ndjeshëm të shoqërisë dhe gazetarët kanë arritur ta ruajnë mirë këtë pjesë duke treguar kujdes të shtruar duke mos publikuar emra apo fytyra të të miturve.

Kjo vlen të duartrokitet dhe është shumë e rëndësishme sepse në disa raste ka raportime për fëmijë që është kategori shumë ndjeshme dhe lajmet që shkruhen për ta duhet që të kemi shumë kujdes.

Madje ka raste kur raportohet dhe publikohet edhe identiteti i tyre që është kryekëput shkelje e të drejtave të tyre.

Figura 6. Foto nga raportimi i GazetaExpress

Figura 7. Foto nga raportimi i GazetaExpress

Rastet e gjetura gjatë periudhës së caktuar nuk kanë gjuhë të urrejtjes sepse gazetarët kanë pasur kujdes gjatë raportimit të këtyre ngjarjeve të cilat me të vërtetë janë ngjarje që prekin shoqërinë në përgjithësi.

Madje kanë ruajtur edhe identitetin e fëmijëve duke mos i shfaqur fare në artikull apo në videon të cilën ja kanë bashkangjitur.

Duke u nisur nga të gjitha këto hulumtime të bëra del që rubrika që mund të konsiderohet e mbushur kryekëput me gjuhë të urrejtjes është ajo e showbizit, e sidomos në titujt që nuk lidhen në disa raste fare me brendësinë e artikullit.

6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për këtë punim akademik janë zgjedhur dy portalet më të klikuara në vend dhe janë analizuar disa artikujt për një periudhë të caktuar kohore.

Nga hulumtimi i bërë kemi arritur në disa konkluzione.

Fillimisht, portali IndeksOnline në artikujt ku kemi hasur gjuhë të urrejtjes ka përdorur në shumicën e rasteve shprehjen "Pa fije turpi", madje mund të themi që në pjesën dërrmuese dominon kjo shprehje.

Madje kemi dalluar që nuk lidhet titulli në shumicën e rasteve me brendësinë e lajmit apo artikullit, sepse në disa raste në brendësi nuk ka fare lajm.

Njëlloj ka vepruar edhe Gazeta Express, vetëm se ka një dallim nga portali tjetër i analizuar.

Gazeta Express ka raste kur titulli lidhet me brendësinë e lajmit, por ka gjuhë të urrejtjes vetëm në titull dhe jo në artikull brenda kur klikohet lajmi. E gjithë kjo bëhet për të arritur që lajmi të klikohet sepse përdoren shumë titujt që në thelb kanë vetëm senzacion.

Portali IndeksOnline dhe Gazeta Express kanë edhe një dallim tjetër. Më shumë gjuhë të urrejtjes tek IndeksOnline kemi gjetur tek rubrika rozë, ndërsa tek Gazeta Express ka edhe tek lajmet apo ballina.

Madje më e shprehur tek Gazeta Express janë lajmet kundër komunës së Prishtinës apo Lëvizjes Vetëvendosje, sepse të gjithë artikujt e gjetur për këtë periudhë kohore që është marrë për analizim tek rubrika e lajmeve janë vetëm për Vetëvendosjen, përjashtim bën vetëm një artikull.

Por çka vlen të ceket është fakti që nuk ka një ndryshim të madh në raportimet që bëhen në mediet online, sepse tendenca kryesore është arritja e klikimeve të shumta nga ana e medieve online.

REFERENCAT

Bibliografia

Grup Autorësh (2013):*Gjuha e urrejtjes.* Shkup, Maqedoni. Polyesterdaz.

Yihr, (2003):*Në emër të lirisë së shprehjes*. Prishtinë, Kosovë. ISHMN.

Russ Mohl, S. M (2010):*Gazetaria.* Tiranë, Shqipëri. Natyra.

KPM- KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE http://www.kpm-ks.org/?faqe=8HYPERLINK "http://www.kpm-ks.org/?faqe=8&gjuha=1&mod=dokumentet"&HYPERLINK "http://www.kpm-ks.org/?faqe=8&gjuha=1&mod=dokumentet"gjuha=1HYPERLINK "http://www.kpm-ks.org/?faqe=8&gjuha=1&mod=dokumentet"&HYPERLINK "http://www.kpm-ks.org/?faqe=8&gjuha=1&mod=dokumentet"mod=dokumentet

http://indeksonline.net/enca-je-ka-e-tepron-me-keto-provokime-na-ke-lodhe-foto/[E qasshme 20 janar 2018]

http://indeksonline.net/veturat-e-gjumit-ne-prishtine-foto/ [E qasshme 7 janar 2018]

http://indeksonline.net/bleona-ska-fije-turpi-perseri-shfaqet-pa-te-brendshme-foto/[E qasshme 26 dhjetor 2017]

http://indeksonline.net/pa-fije-turpi-e-rrah-nenen-dhe-babain-e-arreston-policia-e-kosoves/[E qasshme 13 janar 2018]

http://indeksonline.net/kjo-bukuroshe-nga-sot-eshte-keshilltare-e-nje-ministri-foto/[E qasshme 26 dhjetor 2017]

http://www.gazetaexpress.com/lajme/nje-cerdhe-ne-fushe-kosove-i-ndeshkon-femijet-me-privim-nga-ushqimi-472421/?archive=1 [E qasshme 9 dhjetor 2017]

http://www.gazetaexpress.com/lajme-nga-shqiperia/edmond-preka-dhe-dy-femijet-qe-humben-jeten-keto-jane-viktimat-e-aksidentit-ne-shkoder-501438/ [E qasshme18 shkurt 2018]